



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli: “Konsultim për “Propozim për miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a ”

Propozuesi: Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimmarrje.

Sqarime: Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a ”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me grupet e interesit do të zhvillohet më datë 23.10.2023 ora 13:00 në ambjentet e Pallatit të Sportit Elbasan, ndërsa takimi me qytetarë në datë 23.10.2023 në orën 16:00 në ambjentet e qendrës Rinore.

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Kryetar i Këshillit Bashkiak,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Elbasan, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, grupe interesi.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a ”.
------------------------------	--



Përshkrimi i çështjes.	<p>Administratori i Shoqërisë ka kërkuar shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë. Nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë “Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a, është miratuar kërkesa e Administratorit dhe është propozuar fillimi i procedurave të shitjes së një pjesë të aksioneve të shoqërisë, për të mundësuar afrimin eventualisht të investitorëve të suksesshëm, të cilët mund të paraqesin interes për të qenë pjesë në pronësi të kësaj Shoqërie Aksionere.</p> <p>Një propozim i tillë gjen mbështetje edhe nga Drejtoria e Politikave të Sportit, Rinisë Dhe Aktiviteve , në Bashkinë Elbasan.</p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në ditën e mbajtjes së takimit.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t’u shqyrtuar nga ana e Këshillit:
Dokumentacioni, në lidhje me çështjen që konsultohet.	<p>Relacion Nr. 5711 Prot, më 10.10.2023</p> <p>Propozim për miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a</p>

KRYETARI

Lutfi LALA



REPUBLIKA SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË SPCRTIT, RINISË DHE AKTIVITETEVE

Nr. 571 Prot

Elbasan, më 10/10/2023

RELACION

Propozim për miratimin e shitjes sipas procedurave ligjore, të një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a

DREJTUAR: Këshillit të Bashkisë Elbasan

BAZA LIGJORE:

- Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2(a),(c), neni 36, pika 2 dhe neni 54, pika (e).
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”, ndryshuar me Ligjin Nr.105/2020, neni 11, pika “ç”, neni 20, pika 2 dhe neni 22.
- Ligji Nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, neni 3, neni 11(a) dhe neni 12.
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 116, neni 17 (pika 1/"b") e vijues.
- Kodi Civil i RSH, neni 705 e vijues.

Të Nderuar Antëtarë të Këshillit të Bashkisë Elbasan,

Sa më poshtë, po Ju paraqesim një përshkrim të veprimtarisë së shoqërisë aksionare “Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a, gjatë dy viteve futbollistike, si dhe propozimin e organeve drejtuese dhe mbikqyrëse të saj, për shitjen e një pjese të aksioneve të kësaj shoqërie.

Shoqëria aksionare “AKADEMIA E FUTBOLLIT ELBASANI” sh.a. është themeluar në vitin 2021, konkretisht përmes Vendimit Nr. 61 datë 21.06.2021, të Këshillit të Bashkisë Elbasan “Për miratimin e themelimit të Shoqërisë Sportive “Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a, të konfirmuar me shkresën nr. 734/1 prot datë 29.07.2021 të Prefektit të Qarkut Elbasan. Ajo është regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar më datë 13.07.2021, me NIPT-M13113202A, me statusin e një Shoqërie Aksionare, me sistemin administrimi me dy nivele (Administrator dhe Këshill Mbikqyrës).

Shoqëria aksionare “Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a, me klubet e saj të futbollit të grupmoshave respektive, stafet trajnuese, administrative etj, për vitin futbollistik 2022-2023, arriti të realizojë me sukses objektivat e përcaktuara duke u kualifikuar në **Kategorinë e Parë të Futbollit Shqiptar**. Në këto kushte, kjo shoqëri është në fazën përgatitore me seriozitetin



maksimal për të arritur objektivat e përcaktuar nga organet e saj drejtuese. Më konkretisht, për vitin futbollistik 2023-2024, "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a. do të aktivizohet në Kategorinë e Parë të Futbollit Shqiptar me objektiva shumë ambiciozë, duke pasur si qëllim dërgimin në elitë të futbollit Elbasanas dhe kalimin në Ligën Superiore.

Kjo shoqëri, pavarësisht se është krijuar rishtazi, ka arritur suksese të vijueshme duke rikthyer edhe njëherë traditën e rrënjosur në Qytetin e Elbasanit për një rini të aktivizuar në sportin e futbollit, duke pasur jo vetëm suksese me ekipin e parë të futbollit por edhe me ekipet e grupmoshave të ndryshme.

Shoqëria "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a ka si aksioner të vetëm Bashkinë Elbasan, me kapital themeltar të shoqërisë, në vlerën 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë lekë). Referuar pasqyrave financiare, është evident fakti se një pjesë jo e vogël e shpenzimeve të akvitetit të shoqërisë, është mbuluar nga donatorët e shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a. Kjo sepse, vetëm me kontributet financiare të aksionarit (Bashkia Elbasan), do të kishte qenë i pamundur realizimi i objektivave, sidomos për vitin futbollistik 2022-2023, vit në të cilin kaluam në Kategorinë e Parë të Futbollit në Republikën e Shqipërisë.

❖ Viti i parë i aktivitetit futbollistik 2021-2022

Viti i parë futbollistik 2021-2022, i cili përkon edhe me krijimin e shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a, rezultoi një vit sfidash pasi edhe pritshmëritë ishin shumë të larta. Ndër rezultatet që mund të përmendim janë si më poshtë:

1. Krijimin e ekipit të parë të futbollit si dhe ngritjen e tij në kategorinë e dytë të Futbollit Shqiptar me përfshirje futbollistë të rinj të talentuar, e të trajnuar me staf trajnerësh shumë të kualifikuar dhe me një eksperiencë shumëvjeçare në futbollin Shqiptar
2. Krijimin e ekipeve të grupmoshave si dhe duke i federuar ato pranë Strukturave të Federatës Shqiptare të Futbollit.
3. Ngritjen e stafeve teknike dhe administrative për suportin e mbarëvajtjen e ekipeve të futbollit të Akademisë së Futbollit Elbasani.
4. Promovimin e vlerave të kësaj shoqërie tek aktorët dhe faktorët e biznesit në Qarkun Elbasan, për të thithur donatorë të mundshëm me qëllim suportin financiar të shoqërisë.
5. Identifikimi i problematikave më të mprehta në kuadër të infrastrukturës së ambjenteve të klubeve të Futbollit të Shoqërisë.

Treguesit Financiarë të Shoqërisë për vitin e parë kalendarik 2021 rezultojnë me humbje në vlerën rreth - **5 000 000 (pesë milion) lekë**. Shpenzimet e shoqërisë kanë qenë të fokusuar vetëm tek pagat e punonjësve (futbollistë, Staf teknik e administrativ) si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetsore detyrime ligjore për zbatim.

Duhet të marrim në konsideratë faktin se, kjo humbje ka ardhur si rezultat i pamjaftueshmërisë së të ardhurave nga aktiviteti i Shoqërisë që kryesisht pretendohet të realizohet në drejtim të shitjes së biletave, në stadiumin Elbasan Arena, pasi për këtë vit nuk është zhvilluar asnjë ndeshje e



Klubit Akademia e Futbollit Elbasani pasi edhe ky vit futbollistik vlerësohet si kategori Amatore (Kategoria e III-të).

E megjithatë niveli i humbejeve do të rezultonte më i lartë, në rast se nga stafi drejtues i shoqërisë nuk do të siguroheshin donacione nga donatorë të Qarkut Elbasan e jo vetëm.

Në përfundim të këtij viti futbollistik, shoqëria "AFE" sh.a realizoi objektivin madhor të ngjitet në Kategorinë e II-të, çka ngjalli emocion, dëshirë, respekt dhe vlerësim nga Komuniteti Elbasan qoftë ai sportdashës e jo vetëm pasi edhe informacionet qoftë në media, portale apo edhe rrjete sociale për këtë sipërmarrje të kësaj shoqërie të re futbollit në Qytetin Elbasan, po kthenin në memorien e Qytetit vitet e arta të suksesit të futbollit elbasanas.

❖ Viti i dytë futbollistik 2022-2023

Marrë shkas nga sukcesi i jashtëzakonshëm i arritur, që në vitin e parë të krijimit të Shoqërisë së Futbollit Akademia e Futbollit Elbasani, kur arriti të futej në Kategorinë e II-të të Futbollit Shqiptar, lindi domosdoshmërisht nevoja **për një ristrukturim të shoqërisë për arritjen e objektivave që në sezonin futbollistik 2022-2023 të ngjitet një kategori më lart, pra në Kategorinë e I-rë. Për rrjedhojë lindi nevoja të shtoheshin edhe burimet njerëzore e financiare me qëllim arritjen e objektivit.**

Është ngritur e miratuar me Vendim Asambleje një strukturë organizative e Shoqërisë efiçente dhe profesionale për të arritur objektivat e shoqërisë, por edhe marrë në konsideratë kërkesat ligjore që detyron Legjislacioni për Sportin në këtë drejtim, duke atashuar pranë Klubeve, Punonjës nga Fusha e mjekësisë, Fizioterapisë, Trajningut, Medias, Ekonomisë etj në mbështetje të Klubeve dhe Grupmoshave të futbollistëve.

Në ndryshim nga Struktura e mëparshme e vitit Futbollistik 2021-2022 për vitin futbollistik 2022-2023 u shtuan 6 futbollistë të cilët janë kategorizuar respektivisht sipas cilësive të tyre Cilësor 1; Cilësor 2; Cilësor 3 dhe Cilësor 4.

Kjo emërtesë shërben edhe si kriter përcaktues për Administratorin e Shoqërisë në marrëdhënien kontraktore që ka vendosur me lojtarët respektive sipas cilësive dhe aftësive të çdo futbollisti.

Cilësor 1	do të jenë 7 shtatë futbollistë
Cilësor 2	do të jenë 9 nëntë futbollistë
Cilësor 3	do të jenë 1 një futbollist
Cilësor 4	do të jenë 3 tre futbollistë

Njëkohësisht për shkak të rikostruksionit të Kompleksit Sportiv Shefqet Lameja ka lindur si nevojë e domosdoshme një punonjës ndihmës që do të ketë ndërt të tjera edhe detyrën lidhur me nevojat e përditshmërisë së stërvitjeve të kryera nga Grupmoshat e ndryshme në këtë kompleks duke u marrë me ujtjen e fushës, pastrimin e saj etj.



Për të garantuar e siguruar respektimin e tërë kuadrit ligjor për Shoqëritë tregtare, Legjislacionin për Sportin, Legjislacionit Tatimor etj, lind nevoja edhe për ekspertë të fushës tatimore, fiskale si dhe juridike e për këtë si konsulentë të jashtëm është vlerësuar kontraktimi përmes kontratave të shërbimit edhe për dy ekspertë të fushave të sipërcituara.

Me këtë strukturë organizative u arrit objektivi me ngjitjen në kategorinë e parë e vijuar procesin e rritjes së shoqërisë me qëllim ngjitjen në nivelet e duhura të Futbollit Elbasanas përmes Akademisë së Futbollit Elbasani.

Por sërish në aspektin financiar Shoqëria për vitin kalendarik 2022 shënoi një humbje financiare rreth **- 18 181 760 (tetë mbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë**. Ritheksojmë se, këto shpenzime që kanë rezultuar me humbje reflektojnë vetëm zërat paga e sigurime shoqërore dhe shëndetsore për lojtarët, Stafin Teknik dhe administrativ të shoqërisë, pasi një pjesë jo e vogël e shpenzimeve është mbuluar nga donatorë të Shoqërisë Akademia e Futbollit Elbasani sh.a siç janë:

Shoqëria Kurum
Shoqëria Bukaniku
Shoqëria Solares
Etj....

Ndër donacionet që mund të evidentojmë për vitin 2022 të refeltkuara edhe në vlerë financiare të shtuar të shoqërisë është blerja e një autobuzi autobus si dhe ndriçimi i ambjenteve sportive Shefqet Lamçja. Shumë prej donacioneve për Shoqërinë nga Donatorët kryhet edhe përmes shërbimeve të kërkuara nga ana jonë, siç janë uniforma, shpenzime akomodimi dhe ushqimi në ndeshjet ku ekipi i futbollit ka qenë udhëtues etj

Janë ngritur e federuar ekipet e grupmoshave U-7; U-9; U-11; U-13; U-14; U-15; U-17; U-19 dhe kemi pasur rezultate shumë të mira me ngritjen në kategorinë Supëriore të Futbollit Shqiptar për disa ekipe të këtyre Grupmoshave.

Rritja e interesit të komunitetit Elbasanas për angazhimin e fëmijëve në këtë sport dhe përfshirja e fëmijëve në këto ekipe janë tregues jo vetëm i besimit që kanë tek kjo Shoqëri, por edhe tek serioziteti, profesionalizimi dhe pasioni i stafeve teknike si dhe trupës mbështetëse të Shoqërisë.

Për të vijuar rritjen e shoqërisë, me synim arritjen e objektivave (ngjitjen e "A.F.E" sha në kategorinë Superiore të futbollit Shqiptar) lind domosdoshmërisht nevoja e rifreskimit të Stafit teknik të Ekipit të Parë. Për këtë qëllim afruam e nënshkruam kontratë me njërin nga emrat më të mëdhenj e të suksesshëm në futbollin Elbasan, Z. Nevil Dede, duke i besuar drejtimin e skuadrës. Njëkohësisht është rifreskuar edhe stafi teknik me qëllim arritjen e objektivave trajnues. Gjithashtu, kemi afruar në ekip lojtarë jashtëzakonisht cilësorë, lojtarë fitues dhe kemi nënshkruar kontrata shërbimi me ta për Sezonin futbollistik 2023-2024 e tutje.



Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Elbasan,

Të gjitha këto rekrutime të kryera, por dhe ato që priten të bëhen, janë të domosdoshme për arritjen e objektivit - **kalimin e shoqërisë në Ligën Superiore të Futbollit Shqiptar**. Por njëkohësisht këto rrisin në mënyrë të ndjeshme shpenzimet, të cilat nuk mbulohen dot në vazhdim nga Aksionari i vetëm Bashkia Elbasan, madje as me ndihmën e donatorëve të deritanishëm, apo edhe me ata që mund të paraqesin interes më vonë. **Është e nevojshme që financimi i kësaj shoqërie të bëhet sipas kushteve aktuale të tregut dhe oportuniteteve financiare që krijon menaxhimi privat i shoqërive tregtare.**

Për sa më sipër, Administratori i Shoqërisë ka kërkuar shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë. Nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a, është miratuar kërkesa e Administratorit dhe është propozuar fillimi i procedurave të shitjes së një pjesë të aksioneve të shoqërisë, për të mundësuar afrimin eventualisht të investitorëve të suksesshëm, të cilët mund të paraqesin interes për të qenë pjesë në pronësi të kësaj Shoqërie Aksionere.

Një propozim i tillë gjen mbështetje edhe nga Drejtoria e Politikave të Sportit, Rinisë Dhe Aktiviteve, në Bashkinë Elbasan.

Në përfundim, Ju paraqesim për miratim këtë propozim të organeve të shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a, duke paraqitur projekt-vendimin "Për miratimin e shitjes së një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a.

Bashkëngjitur:

- Projekt-Vendimi "Për miratimin e shitjes së një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a;
- Raport përmbledhës "Mbi veprimtarinë e Shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasani" sh.a";
- Raporti i Ekspertit Kontabël të regjistruar Z.Illir Daiu, me nr. Liçence audituesi ligjor nr.361;
- Vendimi i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Akademia e Futbollit Elbasan" sh.a, ku miratohet Raporti Përmbledhës i Administratorit dhe i propozohet Këshillit të Bashkisë Elbasan të fillojë procedurat për shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë.

ZV.KRYETAR I BASHKISË
Artur GUNI



Konceptoi: Përgj. Enea Jorgji
Specialist. Osman Gjevori
Pranoi : Dr. D.P.S.R.A Jonajda Doçi
Dr. BF Alketa Merkja
Miratoi: D.P.P.A.T.K.T.S Luan Dervishi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan, më _____.2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë ____ .08.2023

**“PËR MIRATIMIN E SHITJES SË NJË PJESE TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
TREGTARE SPORTIVE “AKADEMIA E FUTBOLLIT ELBASAN” SH.A**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin”, ndryshuar me Ligjin Nr.105/2020, neni 11, pika “ç”, neni 20, pika 2 dhe neni 22, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2(a),(c), neni 36, pika 2 dhe neni 54, pika (e), Ligjit Nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, neni 3, neni 11(a) dhe neni 12, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 116, neni 117 (pika 1/“b”) e vijues, Kodit Civil të RSH, neni 705 e vijues, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues dhe ushtrues i të drejtës së pronësisë së personit juridik publik, Bashkia Elbasan, duke marrë në konsideratë nevojat aktuale për financim të sportit të futbollit në qytetin e Elbasanit, bazuar në Relacionin dhe aktin e ekspertimit të paraqitura nga shoqëria “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a., ku bashkia Elbasan aktualisht është pronar i vetëm i 100% të aksioneve, në mbledhjen e tij të datës _____.2023, pasi mori në shqyrtim propozimin e zv.Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a, me NIPT- M13113202A, ku bashkia Elbasan aktualisht është aksionar i vetëm, duke patur pronësinë e 100 aksioneve të shoqërisë.
2. Të nxirren në shitje, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, gjithsej 70 (shtatëdhjetë) aksione, me vlerën minimale të _____ lekë, sipas aktit të vlerësimit të ekspertit kontabël.
3. Autorizohet Kryetari dhe Staf i Bashkisë Elbasan për të zhvilluar të gjitha procedurat e shitjes dhe lidhjen e kontratës së shitjes së aksioneve të shoqërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
ELVI ÇUNI

KRYETARI
Lutfi LALA

Konceptoi: Përgj. Enea Jorgji
Specialist. Osman Gjevori

Pranoi: Dr. D.P.S.R.A Jonajda Doçi
Dr. BF Alketa Merkja

Dr. Juridike Arben Hoxha

Miratoi: D.P.P.A.T.K.T.S Luan Dervishi

Konfirmoi: Zv. Kryetar Artur Guni

Adresa: Bashkia Elbasan", Të 355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. ____ Prot

Elbasan, më ____ . ____ .2023

VENDIM

Nr. ____ datë ____ .08.2023

**“PËR MIRATIMIN E SHITJES SË NJË PJESE TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
TREGTARE SPORTIVE “AKADEMIA E FUTBOLLIT ELBASAN” SH.A**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin”, ndryshuar me Ligjin Nr.105/2020, neni 11, pika “ç”, neni 20, pika 2 dhe neni 22, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2(a),(c), neni 36, pika 2 dhe neni 54, pika (e), Ligjit Nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”, neni 3, neni 11(a) dhe neni 12, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 116, neni 117 (pika 1/“b”) e vijues, Kodit Civil të RSH, neni 705 e vijues, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues dhe ushtrues i të drejtës së pronësisë së personit juridik publik, Bashkia Elbasan, duke marrë në konsideratë nevojat aktuale për financim të sportit të futbollit në qytetin e Elbasanit, bazuar në Relacionin dhe aktin e ekspertimit të paraqitura nga shoqëria “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a., ku bashkia Elbasan aktualisht është pronar i vetëm i 100% të aksioneve, në mëledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, pasi mori në shqyrtim propozimin e zv.Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë shitjen e një pjese të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a, me NIPT- M13113202A, ku bashkia Elbasan aktualisht është aksionar i vetëm, duke patur pronësinë e 100 aksioneve të shoqërisë.
2. Të nxirren në shitje, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, gjithsej 70 (shtatëdhjetë) aksione, me vlerën minimale të ____ lekë, sipas aktit të vlerësimit të ekspertit kontabël.
3. Autorizohet Kryetari dhe Staf i Bashkisë Elbasan për të zhvilluar të gjitha procedurat e shitjes dhe lidhjen e kontratës së shitjes së aksioneve të shoqërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
ELVI ÇUNI

KRYETARI
Lutfi LALA

Konceptoi: Përgj. Enea Jorgji
Specialist. Osman Gjevori

Pranoi: Dr. D.P.S.R.A Jonajda Doçi

Dr. BF Alketa Merkja

Dr. Juridike Arben Hoxha

Miratoi: D.P.P.A.T.K.T.S Luan Dervishi

Konfirmoi: Zv. Kryetar Artur Guni

Adresa: Bashkia Elbasan, Tel. 355 54 0152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al